

PROCES VERBAL

Tipi i kontratës

Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Implementimi dhe investimi ne nje zgjidhje te konsolidur per Integrimin e te dhenave (Middleware).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbimet e implementimit të softwareve – 72263000-6.

VLERA E FONDIT LIMIT:

198.550.000 (Njëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH ose 2,027,883 (Dy milion e njezet e shtate mije e teteqind e tetedhjetë e tre) euro pa TVSH, ***Sipas kursit zyrtar te dates 29.08.2025.***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP sh.a, ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim te vena ne dispozicion nga grupi i punes per kete proces, për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Kompania OSHEE Group sh.a. kërkon te prokurojë Implementimin dhe investimin ne nje zgjidhje te konsolidur per Integrimin e te dhenave (Middleware) i cili është një sistem kompleks, qe përfshin licensa per platformen e integrit, sherbime te implementimit te platformes dhe sherbime suporti.

OSHEE Group Sh.a. synon te konsolidoje shkembimin e te dhenave permes nje shtrese te vetme nderveprimi. Kjo platforme do te zevendesojë lidhjet ad-hoc aktuale me modele integrimi te kontrolluara, te cilat jane me te lehta per t’u shkallezuar dhe mirembajtur. Edhe pse sistemet jane tashme te nderlidhura, integrimet ekzistuese mbesheten ne metoda jo-standarde te cilat kufizojne shkallezueshmerine, fleksibilitetin dhe menaxhimin.

Implementimi i një APIG do të ndihmojë OSHEE-në të adresojë një qasje të unifikuar për komunikimin midis shërbimive. APIG duhet të veprojë si një pikë qendrore e identifikimit dhe autorizimit, duke ofruar një qasje të sigurt dhe të standardizuar për komunikimin midis shërbimive. Me një APIG, shërbimet do të zhvillohen, shpërndahen dhe integrohen me lehtësi, duke kursyer kohë të konsiderueshme zhvillimi dhe integrimi

Nisur nga procesi i kompleks i punes qe ky shërbim ka si qëllim, kjo procedure nuk mund te ndahet ne lote, pasi eshte e pamundur te ndash pergjegjsite dhe Kohen e reagimit ne rast problemi.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenin 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 198.550.000 (Njëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti / enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “e hapur shërbime – mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma” a” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

1. dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit) është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohej. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në kete procedure eshte gjykuar qe vlera e xhiros se kerkuar te jete minimalisht sa 100% e vleres se parashikuar te kontrates.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar.

Përkatesisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshem gjate 3 (tre) viteve të fundit 2022, 2023, 2024. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve gjithashtu të jete të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “përcaktohet se:” Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të

cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:**

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 79,000,000 (Shtatëdhjetë e nëntë milion) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- *Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**".*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavaresisht rendesise dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 40 % e vlerës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK, e cila ka në funksionim një seri sistemesh të nderlidhura dhe të informatizuara e teknologjise së lartë dhe me impakt shumë të madh financiar në rast bllokimi apo mos-funksionimi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ISO 27001:2013 ose ekuivalente për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (e vlefshme) dhe **ISO/IEC 20000-1** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit (e vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet / certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Konkretisht:

Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent, shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjale në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese. Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të vendosur në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rendesinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group SHA ka në përdorim.

Përkatesisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- Duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.
- Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutorë dhe normative të aplikueshme.

Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 27001:2013 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjale duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rendesi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi i tyre të jetë i verifikueshëm dhe i kodifikuar. Kjo vjen pasi në këto kontrate do të ketë edhe përdorim të aplikacioneve të reja për diagnostikimin e elementeve të sigurisë së sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këto drejtim. Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të vendosur në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rendesinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group SHA ka në përdorim.

Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 20001-1 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjale duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjise së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirembajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi, i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware). Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të vendosur në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rendesinë e funksionalitetit online të sistemeve aktuale që OSHEE Group SHA ka në përdorim.

Theksojme se ne te gjitha procedurat ku eshte vendosur si kerkese qe OE te disponojne ISO 27001 nga ana e njesise eshte perditesuar standarti duke kerkuar ISO 27001:2022 (pas konsultimit me fagen zyrtare te DPS), por nga ana e KPP-se nepermjet me vendimin Nr. 376/2024 date 18.04.2024 eshte arsyetuar mbeshtetur edhe ne perqijjen qe ka marre nga DPA (citojme pjese nga arsyetimi: Në përqijje të shkresës tuaj nr. 714/6 prot., datë 08.03.2024 “Kërkesë për 12 informacion” ju informojmë se certifikatat e lëshuara sipas ISO/IEC 27001:2013 nga OVK e akredituar nga DPA, për klientët e tyre, janë të vlefshme deri në datë 31.10.2025. Forumi Ndërkombëta i Akreditimit (IAF) ka vendosur një periudhë tranzitore 3 vite (36 muaj) për kalimin nga standardi ISO/IEC 27001:2013 në standardin ISO/IEC 27001:2022. Referuar dokumentit IAF MD 26:2022, versioni 1, periudha e tranzicionit për standardin ISO/IEC 27001:2022 do të vazhdojë deri në datë 31 tetor 2025) qe iso ISO 27001:2013 eshte e vlefshme gjate periudhes tranzitore deri në datë 31 tetor 2025.

2.3.3 Operatori pjesëmarrës për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas termave të references të projektit, duhet të vërtetojë se ka të punësuar ose me kontratë bashkëpunimi jo më pak se 10 (dhjete) punonjës qe do të angazhohen në implementimin e projektit, të diplomuar në Shkenca Elektronike / Informatike Ekonomike / Telekomunikacion, stafi të jete i vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, **diplomë** përkatëse, në mënyrë të kombinuar të këne Certifikatat perkatese (si meposhte) si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, nga të cilet:

- a) Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne Project management PMP ose ekuivalente.
- b) Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT si ITIL ose ekuivalente
- c) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per analize sistemesh ose ekuivalente.
- d) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per databaza relacionale; 1 per MSSQL dhe 1 per Oracle, ose ekuivalente
- e) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per zhvillim software ose ekuivalente.
- f) Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per platformen e ofruar
- g) Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sistemin financiar referuar specifikimeve teknike.
- h) Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sistemin e menaxhimit dhe mirembajtjes se asetëve, referuar specifikimeve teknike.
- i) Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sistemet operative si MS. Windows Server ose LINUX ose UNIX.
- j) Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar si DevOps ne nivel arkitekt ose ekuivalent, referuar teknologjise se kerkuar per platformen objekt kontrate, referuar specifikimeve teknike
- k) Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per pajisje Server dhe Storage, me qellim konfigurimin e infrastruktures se nevojshme hardware ku do te mbeshtetet platforma objekt kontrate
- l) Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per platforme virtualizimi VMware ne nivel profesional, per te mbeshtetur ngritjen e makinave virtuale te nevojshme, duke qene qe platforma e virtualizimit e perdorur ne OSHEE eshte VMWare.
- m) Te pakten 1(nje) punonjes te certifikuar si auditues i certifikuar i sistemeve informatike, per te siguruar qe platforma e ofruar dhe konfigurimet e kryera per integrimin e gjithë sistemeve sipas specifikimeve teknike eshte kryer me cilesine dhe nivelin e duhur te sigurise se informacionit.
- n) Te pakten 1(nje) punonjes te certifikuar si analist i ngjarjeve ne fushen e cybersecurity, me qellim qe te mbeshtete integrimet e sigurta dhe shkembimin e sigurt te informacionit midis sistemeve si shprehur ne specifikimet teknike

Nje punonjes mund te disponoje me shume se nje certifikim.

Per te vertetuar disponimin e stafit te mesiperm operatori Ekonomik duhet te paraqese:

- Certifikata perkatese / Transkriptet perkatese / Diplomat.
- Listepagesat sipas formularit E-Sig 025/a per muajin e fundit te deklaruar sipas legjislacionit ne fuqi, (duke marre si reference data e hapjes se ofertave).
- Kontraten/at e punes konform legjislacionit ne fuqi te lidhura me stafin e nevojshem dhe CV-ne.

Për të përmbushur këte kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Lidhur me kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 Shtuar me VKM 498/2024 22 Shtuar me VKM 498/2024 30 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin minimal të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi Teknik: Për realizimin e këtij shërbimi kerkohen 10 (Dhjetë) specialiste që në secilen nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdorë personel teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Fushat e mesiperme të ekspertizës, si dhe numri i personelit të certifikuar, janë kryer në bazë të komponenteve të projektit, si dhe të masës së angazhimit të specialisteve. Diplomimi i punonjesve në degët Shkenca Elektronike/ Informatike Ekonomike/ Telekomunikacion, është kërkuar në përputhje me objektin e prokurimit dhe termat e referencës, pasi ky objekt prokurimi përfshin implementimin, adaptimin, testimin, migrimin dhe instalimin e të gjitha informacioneve teknike të sistemit, si dhe duhet të ofrojë trajnim për përdoruesit.

Stafi i operatorit ekonomike duhet të disponojë certifikimet teknike si më poshte:

1. Te pakten 1 (nje) punonjes te çertifikuar ne Project management PMP ose ekuivalente.

Argumentim: Ky kriter garanton AK që operatori ekonomik ka në përberje të tij stafin me aftësi profesionale në mënyrë që i gjithë projekti të realizohet konform të gjitha kërkesave dhe afateve të përcaktuara në DST dhe specifikimet teknike. Punonjësi i certifikuar si menaxher projekti garanton organizimin e njerezve dhe burimeve të OE për të pasur zbatim të suksesshëm të projektit sipas standarteve dhe praktikave me të mira ndërkombëtare, duke marrë në konsideratë rendesinë dhe kompleksitetin e projektit të integritetit të Sistemit Financiar dhe Sistemit të Menaxhimit të Aseteve. Një menaxher projekti është përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të programit.

2. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e sherbimeve IT si ITIL ose ekuivalente

Argumentim: Ky kriter garanton AK qe operatori ekonomik ka ne perberje te tij stafin me aftesi profesionale ne menyre qe i gjithë projekti te realizohet konform te gjitha kerkesave dhe afateve te percaktuara ne DST dhe specifikimet teknike. Punonjesi i certifikuar si menaxher i sherbimeve IT ose ITIL garanton organizimin e njerezve dhe burimeve te OE per te pasur zbatim te suksesshem te peirudhes se mirembajtjes. Ai eshte pergjegjes per ndjekjen e te gjithë ciklit te mirembajtjes se sistemit gjate gjithë kohezgjatjes se tij.

3. Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per analize sistemesh ose ekuivalente.

Argumenti: Ky kriter garanton AK per aftesite profesionale per analizimin dhe perpunimin e te dhenave per objektin e kontrates, duke perdorur mjete dhe teknika te avancuara per zhvillimin dhe menaxhimin e bazave te te dhenave, duke siguruar integritetin dhe saktesine e te dhenave, bashkepunim me ekipin per te zhvilluar dhe implementuar strategji per mbledhjen dhe perpunimin e te dhenave teknike, realizimi i modeleve per integrim per te mbeshtetur vendimmarrjen dhe planifikimin per ekzekutimin sa me professional te kontrates

4. Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per databaza relacionale; 1 per MSSQL dhe 1 per Oracle, ose ekuivalente

Argumenti: Keto punonjes qe zoterojne certifikimet e permnedura do te sjellin pervojë ne trajtimin e te dhenave ne shkalle te gjere, sigurimin e performances se larte dhe zbatimin e masave te sigurise ne databazet e sistemeve te ndryshme sipas specifikime teknike. Pervoja eshte thelbesore per parashikimin e problemeve te mundshme, optimizimin e performances dhe sigurimin e integritetit te te dhenave ne te gjithë sistemin. Per me teper, keta punonjes duhet te orientojne ekipin ne konfigurimin optimal te teknologjive te ndryshme te databazave te sistemeve qe jane objekt i integritit ne platforme, duke integruar pa problem me arkitekturen e software-it dhe duke shkallezuar infrastrukturen e bazes se te dhenave per te trajtuar ne menyre efikase vellimet ne rritje te te dhenave. Planifikon, implementon dhe menaxhon strukturen dhe operacionet e bazave te te dhenave, duke siguruar performancen dhe integritetin e te dhenave. Do te implementojne dhe mirembajne politikat e sigurise se te dhenave ne databaza per te mbrojtur informacionin dhe per te parandaluar aksesin e paautorizuar.

5- Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per zhvillim software ose ekuivalente.

Argumentim: Kriteri garanton AK per aftesite profesionale te punonjesve qe ka OE. Disponimi i 1 (nje) Software inxhinier te certifikuar per zhvillim te aplikacioneve garanton implementimin e te gjithë specifikimeve te kerkuara nga AK lidhur me integrimin e platformave software te listuara ne DST. Gjithashtu keta specialiste garantojne vijueshmerine normale te punes per gjate gjithë periudhes se kontrates. Disponimi i 1 (nje) programues/zhvillues software certifikuar per zhvillimin ose administrimin e bazes se te dhenave vjen si nevoje per te garantuar optimizimin, nderhyrje te pergjegjshme ne bazen e te dhenave si dhe per te garantuar performance maksimale gjate gjithë shtrirjes se kontrate

6- Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per platformen e ofruar

Argumentim: Dy punonjes te certifikuar per platformen e menaxhimit te API sigurojne qe procesi i implementimit te kryhet sipas praktikave me te mira dhe standardeve te prodhuesit. Prania e dy punonjesve te certifikuar mundeson mbulim te plote teknik jo vetem gjate fazes se projektit por edhe gjate fazes se mirembajtjes, duke garantuar zgjidhje te shpejte te problemeve dhe vazhdimesi te sherbimit.

Kjo strukture siguron disponueshmeri te personave me njohje te mire te platformes duke reduktuar varesine nga individe te vetem dhe duke siguruar qendrueshmeri afatgjate te projektit.

7- Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sistemin financiar referuar specifikimeve teknike.

Argumentim: nje nga sistemet kryesore qe edhe mban peshen me te madhe te informacionit qe do te shkembahet eshte ai financiar, duke furnizuar me te dhena shume sisteme te tjera ne OSHEE. per kete arsye, duhet qe gjate zhvillimit te projektit, per realizimin e integritimit te sistemit financiar ne platformen e shkembimit te te dhenave, operatori te kete patjeter nje punonjes me aftesi te certifikuara ne platformen mbi te cilen bazohet sistemi financiar, per te lehtesuar dhe suportuar implementimi e sigurt dhe profesional te projektit.

8- Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sistemin e menaxhimit dhe mirembajtjes se asetave, referuar specifikimeve teknike.

Argumentim: nje nga sistemet kryesore qe edhe mban peshen me te madhe te informacionit qe do te shkembahet eshte sistemi i menaxhimit operacional te asetave, duke furnizuar me te dhena shume sisteme te tjera ne OSHEE si dhe baze per shume raporte analitike dhe statistikore qe i nevojiten OSHEE. Per kete arsye, duhet qe gjate zhvillimit te projektit, per realizimin e integritimit te sistemit te menaxhimit operacional te asetave ne platformen e shkembimit te te dhenave, operatori te kete patjeter nje punonjes me aftesi te certifikuara ne platformen e asetave mbi te cilen bazohet sistemi, per te lehtesuar dhe suportuar implementimi e sigurt dhe profesional te projektit

9- Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per sistemet operative si MS. Windows Server ose LINUX ose UNIX.

Argumentim: me qellim mbeshetjen teknike gjate instalimit dhe konfigurimit te platformes objekt kontrate, duhet prezenca e nje punonjisi me aftesi te certifikuara ne sistemet operative, i cili do te pergatise sistemin operativ sipas nevojave te projektit, ne teknologji te ndryshme si dhe kerkuar ne specifikimet teknike.

10- Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar si DevOps ne nivel arkitekt ose ekuivalent, referuar teknologjise se kerkuar per platformen objekt kontrate, referuar specifikimeve teknike

Argumentim: ky punonjes do te jete pjese e ekipit dhe do te mbeshetese fazat e implementimit me aftesite praktike devops, pasi sistemi objekt kontrate eshte kerkuar qe te suportoje arkitekture te

bazuar ne mikroservice. Aktivizimi i nje punonjesi me keto aftesi teknike do te ndihmoje ne zbatimin profesional dhe te suiksesshem te implementimit te platformes se shkembimit te te dhenave.

11- Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per pajisje Server dhe Storage, me qellim konfigurimin e infrastruktures se nevojshme hardware ku do te mbeshtetet platforma objekt kontrate

Argumentim: sistemi objekt kontrate do te implementohet ne disa servera, si dhe sqaruar ne specifikimet teknike. Per kete arsye, eshte e domosdoshme qe ne perberje te ekipit te operatorit zbatues te kete te pakten nje specialist per pajisjet server dhe storage qe do te punoje ne bashkpunim me stafin e OSHEE per te provizionuar pajisjet fizike me qellim ngritjen e makinave te nevojshme per implementimin e sistemit.

12- Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per platforme virtualizimi VMware ne nivel profesional, per te mbeshtetur ngritjen e makinave virtuale te nevojshme, duke qene qe platforma e virtualizimit e perdorur ne OSHEE eshte VMWare.

Argumentim: sistemi objekt kontrate do te implementohet ne disa makina virtuale si dhe sqaruar ne specifikimet teknike. Per kete arsye, eshte e domosdoshme qe ne perberje te ekipit te operatorit zbatues te kete te pakten nje specialist per platformen e virtualizimit qe perdoret aktualisht ne OSHEE, VMWare, qe do te punoje ne bashkpunim me stafin e OSHEE per te provizionuar makinat virtuale fizike me qellim implementimin e sistemit.

13- Te pakten 1(nje) punonjes te certifikuar si auditues i certifikuar i sistemeve informatike, per te siguruar qe platforma e ofruar dhe konfigurimet e kryera per integrimin e gjithë sistemeve sipas specifikimeve teknike eshte kryer me cilesine dhe nivelin e duhur te sigurise se informacionit.

Argumentim: nje punonjes me certifikimin e kerkuar siguron qe platforma e kerkuar objekt kontrate te kete kontrole te plota dhe te audituara sipas standarteve nderkometare. Ai do te garantoje perputhshmeri ligjore dhe rregullatore (GDPR, ISO 27001 etj) per te gjitha sistemet e lidhura. Gjithashtu do te mundesoje besueshmeri dhe auditueshmeri te projektit perballe institucioneve dhe paleve te treta.

14- Te pakten 1(nje) punonjes te certifikuar si analist i ngjarjeve ne fushen e cybersecurity, me qellim qe te mbeshtese integrimet e sigurta dhe shkembimin e sigurt te informacionit midis sistemeve si shprehur ne specifikimet teknike

Argumentim: nje punonjes me certifikimin e kerkuar eshte i nevojshem per te identifikuar dhe analizuar sjelljet e dyshimta ne trafikun e API-ve dhe aplikacioneve te lidhura, ai do te mbeshtese zbulimin proaktivte kercenimeve dhe reduktimin e rreziqeve permes monitorimit te vazhdueshem. Gjithashtu do te siguroje qe platforma te kete nje mbrojtje te vazhdueshme kibernetike duke plotesuar aspektet teknike te sigurise se kerkuara gjate implementimit, si permendur ne specifikimet teknike.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / distributori i Autorizuar për shitjen e suportit për sistemin objekt i kësaj procedure, referuar specifikimeve teknike. Ky kriter duhet të provohet nepermjet dokumentacionit të leshuar nga prodhuesi/distributori i autorizuar në emër të Operatorit Ekonomik për territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të prodhuesit/distributorit, autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit të autorizuar si: telefon, fax, e-mail, website, kjo është e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 6 e nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave / shërbimeve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave / shërbimeve sipas kërkesave në specifikimet teknike.

Për të garantuar me sukses përmbushjen e të gjithë kërkesave teknike gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, për të garantuar zgjidhjen e problemeve të paparashikuara që mund të hasë OE gjatë kryerjes së proceseve të punës deri në dorëzim të plotë të kontratës, nevojitet të kenë mbështetje nga prodhuesi për rastet e përballjes me situata të paparashikuara si dhe për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë fazës së realizimit të projektit.

Për produktet software ose komponentet që ofrohen falas nga prodhuesi të cilat vetëm shpërndahen por nuk shiten, nuk është i nevojshëm autorizimi por mjafton që OE të përmendë emrin e komponentit, burimin ku do ta marrë psh website zyrtar, dhe një burim në internet ose dokument të vërtetueshëm nga AK ku përcaktohet që prodhuesi ose distributori i saj e ofron falas dhe lejon shërpndarjen për këdo.

Operatorët ekonomike lidhen me prodhuesit nderkombetare/distributorët e autorizuar të tyre, me qëllim uljen e kostove, marrjen e trajnimeve perkatese për punonjësit edhe gjatë zbatimit të kontratës, marrjen e suportit në nivel prodhuesi në kohë reale, ndaj është domosdoshmërisht dorezimi i këtij autorizimi, në dobi të përdoruesve finale dhe produkteve me cilësori, origjinale dhe me zbatim rigoroz të garancisë, duke siguruar vijueshmërinë në funksionalitetin e mevonshëm, sidomos në periudhën Post-Garanci. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e Operatorit Ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi (prova e origjinalitetit të produkteve), sasi e kohë dhe rrjedhimisht në vijim për të zbatuar kushtet e garancisë.

Argumentimi i specifikimeve dhe termave të referencës

Shënim: specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe të pajisjeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, janë pjesë në DST e kësaj procedure.

Në specifikimet teknike, objekti i kontratës, nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Termat e References dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher të posacem nga titullari, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Shenim: *në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në mbështetje të përcaktimit të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të plotësojë sa më sipër.*